



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 1528 Prot.

Tiranë, më 12 . 05 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1038 PROT., DATË 01.04.2026 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR
TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASIT Z.
FATOS ÇELA DHE ZNJ. RAZIE ÇELA PËR NJË PJESE TË PRETENDIMEVE
TË NGRITURA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Fatos Çela dhe Razie Çela me nr. 717 prot., datë 06.03.2023, nr. 717/1 prot., datë 06.03.2025, nr. 527 prot., datë 20.02.2024, nr. 2556 prot., datë 19.09.2024 dhe nr. 2557 prot., datë 19.09.2024, në të cilat ngrihen pretendime për veprimtarinë e magjistrates S.D., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, si dhe magjistratëve B.M., dhe G.F., me detyrë prokurorë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, në kohën kur shkëlja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1038 prot., datë 01.04.2026, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasit z. Fatos Çela dhe znj. Razie Çela për një pjesë të pretendimeve të ngritura”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e saj. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Gjirokastër, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja “18 shtatori”, ndërtesa nr. 35, pranë Varrezave të Dëshmorëve, Gjirokastër;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

